



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MJEDISIT DHE ZHVILLIMIT TË
QËNDRUESHËM**

**DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM, EMERGJENCAVE
NATYRORE**

**TERMAT E REFERENCËS DHE PËRLLOGARITJA E FONDIT LIMIT PËR
HARTIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MBROJTJEN DHE
RUAJTJEN E BIODIVERSITETIT, BASHKIA TIRANË**

PËRMBAJTJA

1. TË PËRGJITHSHME

1.1. Situata Aktuale e Biodiversitetit në Bashkinë e Tiranës

2. FONDI LIMIT PËR HARTIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MBROJTJEN DHE RUAJTJEN E BIODIVERSITETIT

3. TERMAT E REFERENCËS PËR HARTIMIN PVVMRB

3.1. Detyrat që ndiqen për hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit

3.2. Objektivat e përgjithshme dhe specifike të Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit

3.3. Qëllimi i Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit

3.4. Fazat që ndiqen për hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit

4. AFATI I HARTIMIT TË PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MBROJTJEN DHE RUAJTJEN E BIODIVERSITETIT

5. STAFI DHE EKSPERIENCA

6. MONITORIMI I FAZAVE TË HARTIMIT TË PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MBROJTJEN DHE RUAJTJEN E BIODIVERSITETIT

7. MIRATIMI I PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MBROJTJEN DHE RUAJTJEN E BIODIVERSITETIT

8. REFERENCA LIGJORE

1. TË PËRGJITHSHME

Plani Vendor i Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit (*më poshtë PVVMRB*) do të jetë një dokument planifikimi strategjik, që mundëson zbatimin e politikës kombëtare në fushën e biodiversitetit në nivel vendor. Plani do të tregojë një drejtim për të ardhmen dhe do të nxisë mendimin e përbashkët mes palëve të interesit dhe jo vetëm, që janë të përfshirë në procesin e planifikimit, hartimit, zbatimit të masave praktike dhe veprimeve konkrete në lidhje me mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit.

Plani Vendor i Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit do të jetë një dokument bazë që do të orientojë masa konkrete, por edhe afate kohore të mirëpërcaktuara me qëllim ndërhyrjen në çdo sektor për të mbrojtur dhe ruajtur ekosistemet, habitatet, florën e faunën në territorin e administruar nga Bashkia e Tiranës.

Plani do të hartohet në funksion të Dokumentit të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes së Biodiversitetit dhe do të implementohet gradualisht në të gjithë fushën e veprimit të tij ku çdo faktor do të ketë detyra të qarta dhe të përcaktuara.

PVVMRB do të adresojë të gjitha çështjet dhe do të formësojë një kuadër gjithëpërfshirës duke dhënë zgjidhje në lidhje me secilin element përbërës të diversitetit biologjik.

1.1 Situata Aktuale e Biodiversitetit në territorin e Bashkisë Tiranë

Aktualisht, Bashkia e Tiranës nuk ka një Plan Vendor Veprimi për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit. Ndryshimet demografike në vite dhe urbanizimi janë një nga kërcënimet më të mëdha që ndikojnë drejtpërdrejt në biodiversitet. Kërkesa për rritjen e zonave urbane ka krijuar një ndërthurje të zonave urbane të gjelbra me ndërtime të dendura. Cilësia e jetës në kryeqytet varet nga ekzistenca e zonave urbane të gjelbra. Në Planin e Veprimit Qyteti i Gjelbër për Bashkinë Tiranë (2018) është një pjesë që i dedikohet Biodiversitetit në të cilën janë përshkruar disa masa që mund të merren në lidhje me të. Mirëpo për shkak të ndryshimeve të vullshme që kanë ndodhur në Bashkinë e Tiranës ndër vite, këto masa janë të pamjaftueshme. Për këtë arsye, lind nevoja për hartimin e një Plani Vendor Veprimi për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit, i cili do të shërbejë për ruajtjen e shumëllojshmërisë së florës dhe faunës, si dhe mbrojtjes së ekosistemeve që ndodhen në territorin e Bashkisë Tiranë. Ky plan ka si qëllim rregullimin e përdorimit të qëndrueshëm të biodiversitetit nëpërmjet integritetit të elementëve kryesorë të biodiversitetit në planet, programet dhe vendimarrjet e të gjithë sektorëve të pushtetit lokal. Ruajtja dhe menaxhimi i biodiversitetit paraqet një nivel domethënës vështirësie për shkak të vetë kompleksitetit dhe veçorive të habitateve dhe ekosistemeve që përfshihen në këtë zonë. Fakti që një pjesë e këtyre sipërfaqeve mbartin statusin e zonës së mbrojtur (Parku Kombëtar i Dajtit, Parku Kombëtar “Mali me gropa-Bizë”), ka dhënë një ndikim të përgjithshëm pozitiv në ruajtjen dhe menaxhimin e biodiversitetit.

Bashkia Tiranë nëpërmjet këtij plani synon planifikimin e rritjes së hapësirave të gjelbra me cilësi të lartë që njerëzit mund të aksesojnë dhe ku biodiversiteti mund të jetë i përmirësuar. Rehabilitimi i parqeve ekzistuese (Parku i Liqenit Artificial të Tiranës, Parku i Liqenit të Farkës), krijimi i korridoreve të gjelbra për të lidhur hapësirat ekzistuese të gjelbra me ato që do të krijohen në të

ardhmen e afërt janë disa nga metodat e propozuara për të zvogëluar humbjen e biodiversitetit dhe për të identifikuar ndërhyrjet që mund ta përmirësojnë atë.

Ruajtja e biodiversitetit jo vetëm që siguron mbrojtjen e organizmave që na rrethojnë, si dhe burimet që këto organizma kanë nevojë për të mbijetuar, po gjithashtu mbështet pritsshmëritë tona për një cilësi më të lartë të jetës në të ardhmen. Duke pasur në konsideratë se sa pak njohuri kemi rreth mënyrës se si funksionon natyra, ruajtja e biodiversitetit si një investim i rëndësishëm për të ardhmen është dhurata më e çmuar që ne mund t'u lëmë brezave të ardhshëm.

2. FONDI LIMIT PËR HARTIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MBROJTJEN DHE RUAJTJEN E BIODIVERSITETIT

Bashkia e Tiranës me qëllim përmbushjen e detyrimit ligjor për hartimin e planit vendor të veprimit për mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit, nëpërmjet Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 126 datë 23.12.2022 “Për miratimin e Programit Buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2023”, si dhe Vendimit Nr. 23 datë 17.03.2023 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr.126 datë 23.12.2022 të Këshillit Bashkiak ka akorduar fondin për hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit, si dhe me Urdhër të Zv/Kryetarit të Bashkisë nr. 12378/1, datë 07.04.2023, “Për zëvendësim anëtari të grupit të punës ngritur me urdhrin nr. 41166, datë 21.11.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e termave të referencës dhe përcaktimin e fondit limit konform legjislacionit në fuqi për realizimin e shërbimit “Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit”.

Në përputhje me parashikimet e kuadrit ligjor në fuqi për prokurimin publik, nga ana e autoritetit kontraktor është realizuar përllogaritja e fondit limit që do të përdoret për kontraktimin e subjektit/eve që do të hartojnë Planin Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit.

Fondi limit në total për hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit është përllogaritur në vlerën e **4,115,000** (katër milion e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH dhe **4,938,000** (katër milion e nëntëqind e tridhjetë e tetë mijë) lekë me TVSH.

3. TERMAT E REFERENCËS PËR HARTIMIN PVMRB

Termet e referencës me të gjithë elementët përbërës janë hartuar mbështetur në Ligjin Nr.9587 datë 20.07.2006 “ Për Mbrojtjen e Biodiversitetit” (i ndryshuar), Dokumentin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen e Biodiversitetit.

Këto terma reference do të shërbejnë për të përcaktuar përgjegjësitë, detyrat dhe kualifikimet e kërkuara për konsulentët që do të përgatisin Planin Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit, Bashkia Tiranë.

3.1 Detyrat që ndiqen për hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit.

Detyrat që duhet të zbatohet subjekti i kontraktuar me qëllim hartimin e Planin Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit, janë:

- ✓ Grumbullimi i të dhënave dhe shqyrtimi i literaturës për të vlerësuar gjendjen aktuale të Biodiversitetit në territorin e Bashkisë Tiranë.
- ✓ Përgatitja e draft-raportit të analizës së situatës aktuale.
- ✓ Vlerësimi i elementëve përbërës të Biodiversitetit :
 - Diversiteti i Habitave dhe Ekosistemeve
 - Biodiversiteti Urban
 - Biodiversiteti Bujqësor
 - Biodiversiteti dhe Turizmi
 - Llojet e rrezikuara
 - Mbrojtja e llojeve dhe habitateve

- ✓ Vlerësimi i diversitetit të habitateve dhe ekosistemeve, përfshirë liqene, lumenj, shkurre me gjelbërim të përhershëm apo gjethe rënës, pyje gjethegjëre, pyje halorë, kullota, livadhe verore dhe dimërore.
- ✓ Identifikimi dhe vlerësimin e problematikave me biodiversitetin urban.
- ✓ Vlerësimi i biodiversitetit bujqësor përfshirë diversitetin e bimëve të kultivuara, diversitetin e racave të kafshëve (blegtori), si dhe diversitetin e shpendarisë.
- ✓ Vlerësimi i biodiversitetit dhe turizmit, vlerat rekreative që sjell larmia biologjike dhe ajo e peizazhit e cila mund të përdoret për zhvillimin e turizmit.
- ✓ Identifikimi i problematikës lidhur me llojet e rrezikuara, përgatitja statistikave për llojet e rrezikuara, si: numri i mbetur i llojeve, rritja e përgjithshme ose zvogëlimi i popullatës me kalimin e kohës.
- ✓ Mbrojtja e llojeve dhe habitateve.
- ✓ Identifikimi i faktorëve degradues të ekosistemeve, kërcënimet e habitateve humbja e biodiversitetit, identifikimi i sfidave.
- ✓ Krijimi i inventarit dhe bazës së të dhënave të Biodiversitetit:
 - Inventarizimi i bimëve, bimë medicinale.
 - Llojet e rrezikuara dhe masat që duhen marrë për mbrojtjen e tyre.
 - Inventarizimi i kafshëve dhe shpendëve të egra.

- ✓ Hartimi i tabelës përmbledhëse për të dhënat e nxjerra nga inventarizimi, ku janë të afishuara faktorët dëmtues dhe masat që duhen marrë për luftimin e tyre.
- ✓ Identifikimi i çështjeve kyçe që kanë të bëjnë me aspektet ligjore, administrative, faktorët dhe aktorët që influencojnë.

- ✓ Identifikimi i zgjidhjeve sociale bazuar në potencialet të zonës.
- ✓ Zhvillimi i një vizioni, misioni dhe objektivi kryesor për mbrojtjen e Biodiversitetit.
- ✓ Plani i monitorimit të menaxhimit dhe aktiviteteve që priten të zhvillohen në zonë.
- ✓ Hedhja e të dhënave të grumbulluara në terren dhe përpunimi kompjuterik i tyre.
- ✓ Diskutimi dhe konsultimi i aktiviteteve kryesore të planifikimit dhe zbatimit të planit të veprimit me palët e interesuara.
- ✓ Konsultimi i draft-planit të veprimit me aktorët vendimarrës (Bashkia Tiranë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Njësitë Administrative, banorët, shoqatat, fakultete etj).
- ✓ Reçensime të draft-planit të përgatitur dhe ripunim materiali pas vërejtjeve të bëra.

3.2 Objektivat e përgjithshme dhe specifike të Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit.

Objektivi i përgjithshëm i Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit, duhet të jetë integrimi për mbrojtjen dhe ruajtjen e tij, në proceset e menaxhimit të qëndrueshëm dhe planifikimit brenda sektorëve të ndryshëm të qytetit, si dhe projektet strategjike.

Objektivat specifikë të Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit do të jenë:

- ◆ Përputhja me dokumentin e politikave strategjike për mbrojtjen e biodiversitetit, duke kontribuar në zbatimin e politikave të ruajtjes dhe mbrojtjes së tij.
- ◆ Krijimi i mundësive për të zvogëluar humbjen e biodiversitetit dhe për të identifikuar dhe zbatuar ndërhyrjet që mund ta përmirësojnë dhe shtojnë atë.
- ◆ Krijimi i hapësirave të gjelbra dhe rekreative.
- ◆ Zgjerimi dhe përmirësimi i korridoreve të gjelbra natyrore.
- ◆ Pakësimi i impakteve negative që ndikojnë në gjendjen e ekosistemeve, habitateve, dhe biodiversitetit në tërësi.
- ◆ Në përputhje me SDG-s 15 ku kërkohet mbrojtja , rikualifikimi, promovimi dhe përdorimi i qëndrueshëm i ekosistemeve, menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve, parandalimi i degradimit të tokës dhe humbjes së biodiversitetit.
- ◆ Sigurimi i pjesëmarrjes së gjerë të popullsisë lokale në lidhje me ndërgjegjësimin për biodiversitetin dhe rëndësinë e tij.
- ◆ Menaxhimi i punës për hartimin e planit.

3.3. Qëllimi i Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit

Hartimi i PVVMRB ka si qëllim integrimin e të gjitha elementëve kryesorë të diversitetit biologjik, si ruajtja e habitateve natyrore, florës dhe faunës në planet dhe vendimmarrjet në nivel lokal duke rregulluar përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit, për të siguruar mundësi sociale, ekonomike

dhe kulturore, shëndetsore për mirëqenien e brezave aktuale dhe atyre të ardhshëm. Ky plan do të hartohet për mbrojtjen e biodiversitetit që është pjesë e Bashkisë Tiranë dhe natyrisht në koordinim edhe me njësitë e tjera fqinje apo zonat e mbrojtura nëse është e nevojshme.

Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit është një mjet për të njohur gjendjen aktuale të territorit, dhe të sigurojë një ndërveprim me aktorët dhe Bashkinë si dhe koordinim me institucionet qendrore.

3.4. Fazat që ndiqen për hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit

- a) Puna përgatitore
- b) Puna në terren
- c) Puna në zyrë

Puna përgatitore

- Grumbullimi i të dhënave ekzistuese dhe dokumentave të nevojshme për hartimin e PVVMRB
- Analizimi i të dhënave
- Organizimi dhe menaxhimi i procesit të pjesëmarrjes së aktorëve

Puna në terren

- Ndarja e zonave sipas tipologjive urbane/rurale
- Mjetet për punën e terrenit
- Planifikimi inventarizimeve
- Metoda e inventarizimit
- Evidentimi i efekteve, shkaqeve, aktiviteteve dhe proceseve që kërcënojnë komponentët e biodiversitetit
- Futja e të dhënave dhe kontrolli

Puna në zyrë/raportimi

- Përpunim i të dhënave
- Përgatitja e raportit
- Hartimi i draft-planit
- Vlerësimi financiar

4. AFATI I HARTIMIT TË PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MBROJTJEN DHE RUAJTJEN E BIODIVERSITETIT

Për realizimin e hartimit të Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit parashikohet një afat kohor **4 muajor që fillon me nënshkrimin e kontratës me subjektin e kontraktuar.**

Kontraktori duhet të parashikojë dhe të detajojë në mënyrë të saktë të gjitha fazat e punës së domosdoshme deri në momentin final, atë të miratimit dhe dorëzimit të produktit përfundimtar.

Fazat që ndiqen për hartimin e Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit dhe afatet përkatëse, pasqyrohen në grafikun e mëposhtëm:

NR.	FAZAT E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MBROJTJEN DHE RUAJTJEN E BIODIVERSITETIT	MUAJT E VITIT			
		I	II	III	IV
1.	Nënshkrimi i fillimit të punës, vlerësimin e aftësive të stafit BT				
1.2	Procesi i konsultimit me palët e interesuara dhe identifikimi qëllimeve dhe objektivave të PVVMRB				
2.	Puna përgatitore				
2.1	Grumbullimi i të dhënave ekzistuese dhe dokumentave të nevojshme për hartimin e PVVMRB				
2.2	Analizimi i të dhënave				
2.3	Organizimi dhe menaxhimi i procesit të pjesëmarrjes së aktorëve				
3.	Puna e terrenit				
3.1.	Ndarja e zonave sipas tipologjive urbane/rurale				
3.2	Mjetet për punën e terrenit				
3.3	Planifikimi i inventarizimeve				
3.4	Evidentimi i efekteve, shkaqeve, aktiviteteve dhe proceseve që kërcënojnë komponentët e biodiversitetit				
3.5	Futja e të dhënave dhe kontrolli				
4.	Puna në zyrë				
4.1	Përpunimi i të dhënave				
4.2	Përgatitja e raportit				
4.3	Hartimi i draft planit				
4.4	Vlerësimi financiar				
4.5	Miratimi i PVVMRB				

6. MONITORIMI I FAZAVE TË HARTIMIT TË PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MBROJTJEN DHE RUAJTJEN E BIODIVERSITETIT

Autoriteti kontraktor do të monitorojë fazat e ndryshme të hartimit të Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit dhe punimet që realizohen nga subjekti i kontraktuar nëpërmjet grupit të monitorimit që do të ngrihet me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor.

Grupi i monitorimit do të ketë në përbërje 3 specialistë nga Drejtoria e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Emergjencave Natyrore (Sektori i Programimit dhe Projekteve për Ndryshimet Klimatike, Zhvillimit të Qëndrueshëm), pranë Bashkisë Tiranë, të cilët do të monitorojnë procesin e hartimit të Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit nga subjekti i kontraktuar në lidhje me:

- ✓ Zbatimin e detyrimeve kontraktuale në përgjithësi
- ✓ Përbushjen e kërkesave për punimet e terrenit dhe ato të zyrës
- ✓ Zbatimin e detyrimeve kontraktuale në lidhje me numrin e punonjësve dhe kualifikimet profesionale të stafit të përfshirë në proces nga kontraktori
- ✓ Respektimin e kritereve tekniko-ligjore nga kontraktori gjatë procesit të hartimit të Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit
- ✓ Zbatimin e afateve kohore për realizimin e fazave dhe aktiviteteve nga kontraktori të përcaktuara paraprakisht
- ✓ Detyrime të tjera të kontraktorit

Grupi i monitorimit gjatë realizimit të detyrave të ngarkuara, njofton me shkrim titullarin e autoritetit në lidhje me problematikat që konstaton gjatë procesit të hartimit të Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit si dhe sugjeron masat e nevojshme për zgjidhjen e problemeve dhe zbatimin e detyrimeve kontraktuale dhe tekniko-ligjore nga ana e kontraktorit.

7. MIRATIMI I PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR MBROJTJEN DHE RUAJTJEN E BIODIVERSITETIT

Plani Vendor i Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit i hartuar nga kontraktori, pasi ti nënshtrohet konsultimit me aktorët e fushës (Nj.A. shoqatat, komunitetit) do të dërgohet zyrtarisht për konfirmim në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

8. REFERENCA LIGJORE

Gjatë hartimit të termave të referencës dhe përlogaritjes së fondit limit, janë mbajtur në konsideratë detyrimet që lindin nga kuadri ligjor në fuqi në fushën e biodiversitetit dhe në fushën e prokurimit publik.

Kuadri ligjor përkatës përbëhet nga:

- Ligji Nr. 9587, datë 20/07/2006 “Për Mbrojtjen e Biodiversitetit” (i ndryshuar)
- Ligji Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (i ndryshuar);
- Ligji Nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”;
- Ligji Nr. 46/2019 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër” (i ndryshuar);
- Nr.162, datë 23.12.2020 për “Prokurimin publik”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik”, i ndryshuar;
- VKM nr. 866, datë 10.12.2014 “Për miratimin e listave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve me interes për Bashkimin Evropian”;
- Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit;
- Urdhër i Kryetarit të Bashkisë nr. 12378/1, datë 07.04.2023 , “Për zëvendësim anëtari të grupit të punës ngritur me urdhrin nr. 41166, datë 21.11.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e termave të referencës dhe përcaktimin e fondit limit konform legjislacionit në fuqi për realizimin e shërbimit “ Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen dhe Ruajtjen e Biodiversitetit”.

Nr	Emërtimi/Përshkrimi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Vlera
I.				
1.1	“Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për Mbrojtjen e Biodiversitetit”	1		
Çmimi NETO				
TVSH 20 %				
Çmimi TOTAL				